



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNËS



12Nr. 464/01-51562, dt. 26.11 2020

Bazuar në nenin 11, 12, dhe 40, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34. pika 34. 6, të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe nenit 4, 7 dhe 8, të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Ligji nr. 03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenin 26 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor. Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur me datë, **26.11.2020**, miratoj këtë:

V E N D I M

Për Shpronësimin e njësive të ndërtesave – Banesave, në zonën kadastrale në Gllogoc.

Neni 1

Vendimi për Shpronësimin e njësive të ndërtesave - banesave, të cilat u janë dhënë pronarëve në shfrytëzim të përhershëm nga Komuna e Drenasit, të ndërtuara në pronën komunale, në parcelën nr. 743-29, në zonën kadastrale në Gllogoc.

Neni 2

Shpronësimi i këtyre pronave ka për qëllim realizimin e interesit publik të Komunës, bazuar në Planin Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028, Planin Rregullues Urban Qendra 1 në Drenas.

Neni 3

Pronat e paluajtshme (pjesët e ndërtesave) që do të shpronësohen kanë këto karakteristika:

- 1- Njësia e ndërtesës nr.70315016-27-1-1-0, me sipërfaqe prej 33m², zona kadastrale Gllogoc, me shfrytëzues Agim (Ujkan) Hysenaj nga Abria e Epërme.
- 2- Njësia e ndërtesës nr.70315016-22-2-1-0, me sipërfaqe prej 30m², zona kadastrale Gllogoc, me shfrytëzues Elver (Sheqir) Istogu nga Polluzha.
- 3- Njësia e ndërtesës nr.70315016-27-2-1-0, me sipërfaqe prej 32.8m², zona kadastrale Gllogoc, me shfrytëzues Arbnora (Murat) Velu nga Korrotica e Poshtme.
- 4- Njësia e ndërtesës nr.70315016-00743-1-22-3-1-0, me sipërfaqe prej 35m², zona kadastrale Gllogoc, me shfrytëzues Nezir (Sherif) Prokshi nga Qikatova e Re.
- 5- Njësia e ndërtesës nr.70315016-26-2-1-0, me sipërfaqe prej 33m², zona kadastrale Gllogoc, me shfrytëzues Liridon (Halil) Maxhuni 1/2 dhe Armend (Halil) Maxhuni 1/2.
- 6- Njësia e ndërtesës nr.70315016-25-1-1-0, me sipërfaqe prej 33m², zona kadastrale Gllogoc, me shfrytëzues Tahir (Ukë) Leku Gllogoc.

7- Njësia e ndërtesës nr.70315016-1-26-3-1-0, me sipërfaqe prej 33m², zona kadastrale Gllogoc, me shfrytëzues Xhafer Musli Haliti Gllogoc.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit i cili do të inicion procedurën e mëtejme për shpronësim të objekteve banesore të cilat ndodhen në zonën kadastrale në Gllogoc.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale që nevojiten për shpronësimin e këtyre objekteve.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi Nr. Nr.12-464/01-47360, i datës 30.10.2020, i kuvendit të komunës së Drenasit.

Neni 7

Me këtë Vendim do të njoftohen organet kompetente të Komunës së Gllogocit.

Neni 8

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .

 **Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
Labinot Halilaj